

## TERMAT E REFERENCËS

# AUDITIMI VJETOR I PASQYRAVE FINANCIARE TË ORGANIZATËS

### 1. Profili Caritas Kosova

Caritas Kosova si institucion i bamirësisë promovon drejtësinë, vlerat universale dhe ndërtimin e paqes, përmirëson cilësinë e jetës së qytetarëve, gjithëpërfshirjen sociale, jep shpresë për të pambrojturit dhe kujdeset që të rimëkëmben grupet në nevojë duke i fuqizuar ata në realizimin e të drejtave themelore në të gjitha fushat e zhvillimit njerëzor.

Fushat strategjike në të cilat Caritas Kosova aktualisht është përqendruar janë: *Përkujdesi shëndetësor dhe përmirësimi i qasjes në shërbimet shëndetësore; Përmirësimi i pozitës sociale të njerëzve në nevojë dhe zhvillimi i komunitetit për përfshirje dhe kohezion social; Krijimi i parakushteve për rritjen e punësueshmërisë dhe të vetëpunësimit; Realizimi i së drejtës në edukim dhe arsim cilësor; Ndhurma në situatat e fatkeqësive natyrore dhe të konflikteve.*

### 2. Të dhëna e Organizatës:

- Buxheti Vjetor 2023: **Rreth 4.2 milion euro**
- Numri i Certifikatës së Regjistrimit: **5200022-0**
- Numri i Përfituesit Publik: **6000489-9**
- Numri i TVSH-së: **330242206**
- Numri Fiskal. **600246765**

Caritas Kosova fton firmat ligjore të auditimit që të shprehin interesimin e tyre për auditim në: [info@caritaskosova.org](mailto:info@caritaskosova.org) dhe [alfred.pjetri@caritaskosova.org](mailto:alfred.pjetri@caritaskosova.org), deri më 24.11.2023.

### 3. Kohëzgjatja e detyrës:

Firma e zgjedhur e auditimit do të kontraktohet nga Caritas Kosova dhe do të kryej auditim për Organizatën për 4 vjet (2023, 2024, 2025, 2026). Termat e Referencës janë pjesë integrale e kontratës. Raportet përfundimtare të paraqiten deri më 5 mars të vitit përkatës.

### 4. Qëllimi

Qëllimi i kësaj kontrate është auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për vitet 2023, 2024, 2025, 2026, nga një Firmë Ligjore e Auditimit (lista e KKRF e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve).

Auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare për periudhën, 1 janar - 31 dhjetor të vitit përkatës, siç kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-043 - Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare.

## 5. Objektivat dhe fushëveprimet

Auditimi i kryer duhet të jetë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs). Objektivat kryesore janë marrja e një sigurie të arsyeshme nëse pasqyrat financiare janë të pastra nga keq deklarimet materiale, qoftë për shkak të mashtrimeve ose gabimeve. Keq deklarimet duhet të vijnë nga mashtrimet ose gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimmarrje.

Përgjegjësitë e auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare 2023, 2024, 2025, 2026

- Identifikoj dhe vlerësoj rreziqet e keq deklarimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimeve ose gabimeve, përcaktoj dhe kryej procedura të auditimit që u përgjigjen atyre rreziqeve dhe merr dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin.
- Siguroj një kuptim të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin në mënyrë që të hartoj procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat.
- Vlerësoj përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe informacioneve shpjeguese përkatëse të bëra nga menaxhmenti.

## 6. Rezultatet e auditimit

### **Auditimi vjetor i pasqyrave financiare të organizatës.**

Firma ligjore e auditimit do të lëshojë një Raport të Auditimit në lidhje me rishikimin e Pasqyrave Financiare. Certifikata e auditimit duhet të përmbajë sa vijon:

- a) Një Opinion që duhet të lëshohet se Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISAs).
- b) Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06/L-043 - Për Lirinë e Asociimit në Organizatat Jo-Qeveritare.
- c) Auditori do të lëshojë një letër menaxhimi/memorandum auditimi që përmban sa vijon:
  - përmbajtjen dhe fushën e auditimit
  - vëzhgime të rëndësishme mbi aktivitetin e mbuluar nga raporti

Raporti i auditorit duhet të përfshijë gjithashtu letrën e menaxhimit. Organizata mund të lëshojë një konfirmim me shkrim në lidhje me përfaqësimet e bëra në lidhje me Auditimin.

## 7. Të dhënat, përgjegjësitë, personeli

Firmës ligjore të auditimit do t'i jepet qasje në të gjitha dokumentet, përfshirë Marrëveshjet përkatëse që Caritas Kosova ka nënshkruar, raportet dhe çdo informacion tjetër që lidhet me Pasqyrat Financiare dhe që konsiderohet i nevojshëm nga auditori. Stafi i Caritas Kosova do të

sigurojë gjithashtu mbështetje të plotë për auditorët në lidhje me informimin mbi dokumentacionin, orientimin, udhëzimin dhe mbështetjen për të fituar qasje në mjediset e nevojshme.

### **Të dhënat**

- Gjuha themelore e të gjithë dokumentacionit është gjuha shqipe dhe gjuha angleze.
- Të gjitha dokumentet do të kthehen në fund të Auditimit. Të dhënat e një natyre konfidenciale do të trajtohen me gjithë maturinë e nevojshme dhe do t'u zbulohen vetëm personave të autorizuar.
- Auditimi do të kryhet nga një auditor i jashtëm, i pavarur dhe i kualifikuar në përputhje me standardet ndërkombëtare të përmendura më lart dhe që është i regjistruar dhe licencuar ligjërisht në Kosovë për të kryer një auditim të tillë.
- Firma ligjore e auditimit e cila aplikon për të kryer auditimin do t'i nënshtrohet menjëherë skualifikimit nëse identifikohet ndonjë konflikt i mundshëm interesi ndaj ose në lidhje me Caritas Kosova.
- Raporti i Auditimit duhet të dorëzohet në fund të detyrës, së bashku me Letrën e Menaxhimit, në gjuhën shqipe dhe gjuhën angleze.

### **Personeli**

- Auditimi do të kryhet nën përgjegjësinë e përgjithshme të një Menaxheri të Auditimit dhe përgjegjësinë operacionale të një Udhëheqësi të Ekipit (Auditor i Lartë, të paktën 5 vjet përvojë profesionale të auditimit), mbështetur nga ekipi i konsideruar i përshtatshëm nga Kontraktori (me të paktën 2 vjet përvojë profesionale të auditimit).
- Kualifikimet, aftësitë dhe përvoja e përgjithshme dhe specifike profesionale e Menaxherit të Auditimit dhe Ekipit të Auditorëve do të merren parasysh gjatë vlerësimit teknik të ofertës. Asnjë staf praktikant nuk duhet të përfshihet në Ekipin e Auditorëve në këtë veprim specifik.

### **Akomodimi në Zyrë**

- Hapësira për zyre ku veprimi i ekspertëve të caktuar të auditimit duhet të sigurohet nga firma ligjore audituese dhe nuk duhet të jetë përgjegjësi e Caritas Kosova. Sidoqoftë, bazuar në marrëveshje, një hapësirë për punë, brenda ambienteve të Caritas Kosova, mund të përdoret me pëlqim të dy anshëm dhe me arsyetim adekuat.
- Firma ligjore e auditimit duhet të sigurojë që auditorët mbështeten dhe pajisen në mënyrë adekuate. Në veçanti, do të sigurojë që ka dispozita të mjaftueshme administrative, sekretarie dhe interpretuese për t'i mundësuar auditorëve të përqendrohen në përgjegjësitë e tyre kryesore.

### **Pajisjet**

- Asnjë pajisje nuk duhet të blihet ose të sigurohet nga firma ligjore zgjedhur e auditimit në emër të Caritas Kosova si pjesë e kësaj kontrate shërbimi.